36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

#### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

#### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

**PJESA III E KONTRATES****KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është <b>10%</b> me vlefshmëri prej <b>150</b> dite.
Përgjegjësia dhe Sigurimi Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <b>15</b> ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <b>15</b> ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>15</b> dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	<b>Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 120 ditë kalendarike.</b>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25%</b> e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,

Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga 50.000 € për punët e kryera dhe te konstatuara nga menaxheri i kontratës.  <b>Pagesa e fundit</b> –nuk mund të jetë më e vogël se 10% e çmimit të kontraktuar, bazuar ne konstatimin e menaxherit dhe mbikëqyrësit e kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës.  Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK.  Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.  Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve (5 vite).
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 5 vite.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.  b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.  Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.





***"PE-VLA-KU" SH.P.K***

***PRISHTINË - TIRANË***

***ADRESSA: TRINGE SMAJLI, 16/7***

***NR.UNIK INDETIFIKUES : 810794463***

***TEL: +383/49/201-030***

***pevlaku.ks@gmail.com***

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA**

PARAMASA DHE PARALOGARIA


Implimentimi i planit te mobilitetit

RIKONSTRUIMI I RRUGËS: "BEDRUSH COLLAKU" Gjatësia L=298.51m, Km:0+00-0+298.51

VEPËRNDJE:

- Para fillimit të punimeve, në vend të përshtatshëm dhe të dukshëm të vendndërtimit duhet të vendosen, instalohen, hapësirat e përkohshme (së paku dy kontejner, zhveshtore, toaleta me duarlarë për nevoja të stafit gjatë orarit të punës dhe tërë periudhës së ekzekutimit të punimeve) të O.E për punë, siguri dhe shëndet në punë, gjatë ekzekutimit të punimeve nga fillimi deri në përfundim të tyre. Kontraktori duhet të vendos zyre të përkohshme (së paku një Kontejner) për nevoja të operimit dhe organizimit të punës për stafin e inxhinierëve si dhe për nevoja të mbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit.
- Operatori ekonomik duhet që të bëjë llogarinë, që në çmimin e ofruar për secilin pozicion, në të cilin është specifikuar kualiteti i punës që duhet të ofrohet, duhet të parashikoj ofrimin e dëshmuar (Dokumentacionit) të cilat e dëshmojnë KUALITETIN E PUNËS dhe KUALITETIN E MATERIALIT që është ekzekutuar në vend. (Certifikata të kualitetit, Ateste të ndryshme, Teste laboratorike etj).
- Operatori ekonomik duhet që të bëjë llogarinë, që në çmimin që ofron, sidomos për pozicionet me vëllim të madh të punës të parashikoj MATJET GJEODEZIKE nga inxhinieri gjeodet i licencuar për të gjitha pozicionet e ndërtimit si (matja e vëllimit të gërmimeve, shtresave të materialit mbushës, shtresave të zhavorit dhe shtresave tjera të nevojshme, duke deshmuar sasitë me koordinata të shtresave dhe profile gjatesore, terthore, pastaj matjen e sipërfaqes së asfaltit, kubezave, gjatesine e gypave të kanalizimit fekal, atmosferik, gjatesine e skajoreve, hartimin e profileve, gjatesore të kanalizimeve me raportin e sasive dhe të gjitha pozicioneve tjera të cilat janë pjesë e kontratës dhe që janë të matshme në terren, sipas kërkesës së organit mbikqyres. Gjithashtu inxhinieri gjeodet i licencuar duhet të hartoj deklaratën e punëve për matjet e kryera të nënshkruar dhe të vulosur. Poashtu inxhinieri duhet të jetë prezent në punishte në mënyrë që të përcjellë vazhdimisht punimet gjeodezike sipas projektit, të bëjë inqizime gjeodezike të gjandjes faktike në terren varesisht nga kërkesa e organit mbikqyres të përcaktuar nga AK.
- Operatori ekonomik para se të vendos çmimet në këtë paramasë, duhet të sigurohet se çmimet e secilit pozicion të kësaj paramase, janë në harmoni me përshkrimin se si duhet të realizohen punët që përshkruhen në RAPORTIN TEKNIK. Pra në raport teknik është e përshkruar mënyra, se si duhet të bëhet ekzekutimi i punëve në vendpunishte sipas projektit zbatues.
- Staf PROFESIONAL i operatorit ekonomik duhet të jetë prezent çdo ditë në realizim të projektit dhe komunikimi në mes ekipit të Komunës së Prishtinës dhe Operatorit Ekonomik duhet të bëhet vetëm me stafin profesional të operatorit ekonomik. Pra për çdo pozicion që është duke u realizuar në terren, në këtë kohë O.E duhet të ketë stafin prezent.

Nr. rëndor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
1.0	<b>PUNËT E DEMOLIMIT DHE DEBUT</b>					
1.1	Para fillimit të punimeve, në vend të përshtatshëm dhe të dukshëm duhet të vendosen, të instalohen Pllaka me dimensione të përshtatshme ( min 110/150 cm) me shënime apo të dhënat e projektit për sa i përket : Emrin e Autoritetit Kontraktues, Emrin E Projektit, Numrin e Lejes të Ndërtimit, Emrin e Operatorit Ekonomik, Emrin e Projektuesit dhe të dhëna të tjera me interes apo të nevojshme për projektin dhe vendin e ndërtimit, datën e fillimit të projektit dhe datën e përfundimit etj. Para fillimit të punimeve, në vend të përshtatshëm dhe të dukshëm duhet të vendosen, të instalohen Pllaka me dimensione të përshtatshme ( min 110/150 cm) me shënime apo të dhënat për shenjat e paralajmërimit dhe shenjat e rrezikut për vendin e ndërtimit duke specifikuar edhe masat mbrojtëse dhe paisjet e nevojshme për vendin e ndërtimit.	komplet	1	1,000.00	1,000.00	
1.2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në rrugë.	m'	299	1.00	298.51	
1.3	Inqizimi gjeodezik i gjandjes egzistuese, harmonizimi i kotave në hyrjet - dalje në vendëkalime dhe rrugë anësore pas përfundimit të punimeve të dorëzohet situacioni i rruges.	m'	299	1.50	447.77	




1.4	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe identifikimi i instalimeve nentoksore gjate punimeve, ruajtja e tyre si dhe sanimi i tyre ne rast te dëmtimit.	m'	299	1.00	298.51
1.5	Demolimi dhe transporti deri në deponi i pllakave (kubzave) nga betoni dhe materialeve tjera të ngurta.	m <sup>2</sup>	131	1.50	196.50
1.6	Demolimi dhe transporti deri në deponi i shtresave të asfaltit egzistues me trashësi mesatare t=10cm.	m <sup>2</sup>	1972	1.50	2,958.00
1.7	Prerja vijore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta.	m'	35	5.00	175.00
1.8	Demolimi, rrenimi i skajoreve ekzistues me dimensione: 18x24 me shtresen betonit ekzistues nën skajore me dore dhe me makinerinë e duhurë pa u dëmtuar asfalti i cili kufizohet me skajorë, ngarkimi, transporti deri ne 15 km .	m'	137	1.50	205.50
1.9	Demolimi, rrenimi i skajoreve ekzistues me dimensione: 7x20 me shtresen betonit ekzistues nën skajore me dore dhe me makinerinë e duhurë pa u dëmtuar asfalti i cili kufizohet me skajorë, ngarkimi, transporti deri ne 15 km .	m'	120	1.00	120.00
1.10	Demolime dhe transporti deri ne deponi i objekteve të ndryshme të betonit dhe materialeve tjera të ngurta.	m <sup>3</sup>	35	20.00	700.00
1.11	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	orë	7	10.00	70.00
<b>TOTAL PUNËT E DHEUT , DEMOLIMIT :</b>					6,469.79

Pozicioni (sipas k. tek)	lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
<b>2.0 PUNËT E DHEUT</b>					
2.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km.	m <sup>3</sup>	2762	3.00	8,286.00
2.2	Grryerja, planifikimi, rrafshimi i nënbazës dhe ngjeshje deri në modulën e ngjeshmerisë 25N/mm <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	2389	0.20	477.80
2.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	2538	2.00	5,076.00
2.4	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushes guror jokohorent me CBR>20% , shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mëdha se 30cm deri në modulën e ngjeshmerisë 50MN/m <sup>2</sup>	m <sup>3</sup>	824	9.00	7,416.00
2.5	Furnizimi, transporti, punimi i bankinave me tampon.	m <sup>3</sup>	22	8.00	176.00
2.6	Furnizimi, transporti i drurit dekorativ ma lartësi h=3.0m, trashësi të trungut dmin=10cm, hapja e gropes me dimensione 80cm x 80 cm - thellesi 100 cm, transporti i dheut në deponi si dhe furnizimi per qdo grope me 50 litra substrat duke përfshirë mirmbajtjen, ujitjen dhe ndrrimin e tijë eventual në peridhë 1 vjeqare.	copë	2	250.00	500.00
<b>PUNIMET E DHEUT</b>					21,931.80



Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
9	PUNËT E TAMPONIT, BETONIT DHE ASFALTIT				
3.1	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt si shtres rrafshuese nën kocka betoni me t=5cm (në gjendje të ngjeshur).	m <sup>3</sup>	18	8.00	144.00
3.2	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e rëres së imt si shtres mbrojtëse e gjeotekstilit me t=5cm (në gjendje të ngjeshur).	m <sup>3</sup>	119	8.00	955.60
3.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>80MN/m <sup>2</sup> prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-63mm me trashësi t=40cm si bazë për vendosjen e trupit të rruges.	m <sup>3</sup>	892	10.00	8,920.00
3.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>100MN/m <sup>2</sup> prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-31.5mm me trashësi t=15cm si bazë për vendosjen e asfaltit.	m <sup>3</sup>	332	11.00	3,652.00
3.5	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve të plotë të bardh(agregat dhe cement të bardh) 18/24/80 me kualitet acc. nga klasa C30/37, M100 në shtresë betoni me trashësi t=12cm dhe klasë C16/20.	m'	580	11.00	6,380.00
3.6	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 7/20/50 me kualitet sipas acc. EN1340.2003 nga klasa C30/37 vendosur në shtresë betoni me trashësi t=10cm dhe klasë C16/20.	m'	575	7.00	4,025.00
3.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i Pllakave të betonit MB40 dhe trashësi t=80mm dy shtresore (dimenzione: 30x20 dhe 20X20) ose të ngjashme ku shtresa e parë është nga betoni I presuar ndërsa shtresa e dytë nga materialet e grimcuara si : Graniti, Kuarci, Diabazi etj me trashësi t=15mm, (trashësia në vlera referuse të standarteve evsopian EN 13748-2. Pllaka për përdorim në hapsira të hapura në ambient të jashtëm. Për të qen i kualifikuar si material duhet të plotsoj standartet : EC(deklaration of conformity), Produkti të posedoj shenjën CE në përputhje me direktivat per CPD (Construction Product Directive) dhe EN 13748-2 per Pllaka të ambienteve të jashtme. Montimi përfshinë edhe mbushjen e fugave me rërë të imët si dhe ngjeshja e tyre. Ngjyra e pllakave dhe dizajni i montimit përcaktohet nga mbikqyrësi në bashkpunim me projektuesin.	m <sup>2</sup>	398	20.00	7,960.00
3.8	Furnizimi , transporti dhe punimi i shtresës së bitoagregatit: 31CS me BIT 50/70 me trashësi t=10.0cm si dhe sterpikjen me emulzion në hapsirate rrugës.	m <sup>2</sup>	2045	11.00	22,495.00
3.9	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm AB16, PmB 50/70-65 me përforcues të asfaltit me përberje të fibrave të Aramidit dhe Polyolefineve (ekuivalent me FORTA Ff) ose materiale të tjera me përbanje dhe karakteristika të njejta (500gr/1 ton asfalt) me trashësi t=5,0cm si dhe sterpikjen me emulsion në tër hapsirën e shiritit të komunikacionit.	m <sup>2</sup>	2045	7.00	14,315.00
TOTALI PUNËT E TAMPONIT, BETONIT DHE ASFALTIT					68,846.60




4		SINJALIZIMI VERTIKAL				
4	4.1	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë trekëndëshe me gjatësi të brinjës së trekëndëshit barabrinjës prej 900 mm.	copë	1	110.00	110.00
	4.2	Furnizimi dhe vendosja (përfshirë të gjitha operacionet dhe pajisjet mbajtëse) e shenjave të trafikut në formë rrethore përfshirë dhe shenjen STOP me diametër 600 mm.	copë	11	110.00	1,210.00
Verejtje: Foliet e sipërfaqeve retroreflektuese të shenjave të trafikut duhet të punohen së paku të shkallës së						
<b>TOTALI SINJALIZIMI VERTIKAL</b>					<b>1,320.00</b>	

5		SINJALIZIMI HORIZONTAL				
5	5.1	Furnizimi dhe punimi në rrugë të vijave gjatësore të bardha të plota (gjerësia 120 mm)	m'	930	0.90	837.00
	5.2	Furnizimi dhe punimi në rrugë me vija gjatësore të bardha të ndërprera (1+1 m, me gjerësi 120 mm)	m'	70	1.00	70.00
	5.3	Furnizimi dhe punimi në rrugë të vijave të bardha tërthore (të plota) të ndalimit (gjerësia 500 mm)	m'	20	1.00	20.00
	5.4	Furnizimi dhe punimi në rrugë për vendosjen e shigjetave për orjentim të lëvizjes.	m <sup>2</sup>	2	20.00	40.00
Verejtje: Shenjat horizontale duhet të punohen nga masat e perziera plastike dy komponenteshe me perberje të grimcave fluoescente						
<b>TOTALI SINJALIZIMI HORIZONTAL</b>					<b>967.00</b>	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA		
1.0	PUNËT E DEMOLIMIT	6,469.79
2.0	PUNËT E DHEUT	21,931.80
3.0	PUNËT E TAMPONIT, BETON DHE ASFALTIT	68,846.60
4.0	SINJALIZIMI VERTIKAL	1,320.00
5.0	SINJALIZIMI HORIZONTAL	967.00
<b>Totali:</b>		<b>99,535.19</b>

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK						
• "Rruga "Bedrushë Collaku"						
Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
<b>1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT</b>						
1.1		Trasimi-piketimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike sipas projektit, i cili shërben për përcjelljen e punimeve, gjatë ekzekutimit të punimeve të kanalizimit.	m'	370	1.50	555.00
1.2		Inçizimi, i rrjetit sipas gjendjes së ekzekutuar të kanalizimit (pas ekzekutimit të rrjetit të kanalizimit). Inçizimi gjeodezik duhet të bëhet nga kompanija e licensuar për këtë lloj aktiviteti. Materiali duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	300	1.50	450.00
1.4		Realizimi i lidhjeve të gypave të kanalizimit atmosferik nga objektet egzistuese në rrjetin e ri të kanalizimit, duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	10	30.00	300.00
1.5		Realizimi i lidhjes së gypit të projektuar në pusetat ekzistues për shkarkim, duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	1	100.00	100.00



1

1.6	Gërmimi me dorë , makinë, dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohen në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në H= 2,0m' , kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i rrydit.				
a	gërmimi me makinë 90%	m <sup>3</sup>	490	3.00	1,470.00
b	gërmimi me dorë 10%	m <sup>3</sup>	55	3.50	192.50
1.7	Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësinë e kanalit.	m'	280	2.50	700.00
1.8	Zgjerimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 75 puseta	m <sup>3</sup>	25	10.00	250.00
1.9	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m <sup>2</sup>	280	1.00	280.00
1.10	Furnizimi, shtrirja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt:	m <sup>3</sup>	145	7.00	1,015.00
1.11	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresën e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	300	0.50	150.00
1.12	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m2.	m <sup>3</sup>	215	9.00	1,935.00
1.13	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	3	10.00	30.00
<b>TOTAL PUNËT E DHEUT :</b>					7,427.50

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		<b>2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME</b>				
2.1		Përpunimi i fundit të pusetës kontrolluese me C-20/25 (për punimin e pllakes nga betoni dhe kinetave sipas detalit në projekt). Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 20cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.				
a		për puseta rrugore	m <sup>3</sup>	5	100.00	500.00
2.2		Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për puseten e ujmbledhësave me dim: 60*40cm.	copë	13	30.00	390.00




2		Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën pusëtë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusëtës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				
	2.3					
	a	Unaza në formë të konit	copë	13	25.00	325.00
	b	Me profil konstant	m'	58	15.00	870.00
					<b>TOTALI</b>	<b>2,085.00</b>

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		<b>3,0 PUNËT METAL PUNUESE</b>				
3	3.1	Furnizimi transporti montimi i kapakëve prej gize DN-600 mm, konform Standardit EN124, klasa D400 kN, pesha e kapakut T=40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej beton-armesë C-25/30. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.				
	a	për puseta rrugore	copë	13	100.00	1,300.00
	3.2	Shkallët në puseta Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusëtës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logaritja me copë.				
a	për puseta rrugore	copë	52	1.50	78.00	
3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësat (prej gize), për pesha të rënda. Në çmim të llogarohet: betonimi i kurorës prej beton armesë C-25/30.			12	80.00	960.00
					<b>TOTALI</b>	<b>2,338.00</b>

<b>4,0 PUNËT E MONTUESE</b>						
4	4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar të kanalizimit PE SN8, në bazë të standardit EN 13476-3 dhe ISO 9969, duke përfshirë edhe lidhjen e gypave me puseten e kanalizimit, duke mbyllur zbrazdësirat me llaq çimento, në mënyrë që të mos ketë infiltrime të ujrave anësore si dhe ujrave nëntokësore në puseta. Paga bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet.				
	a	DN- 200 mm	m'	70	6.50	455.00
	b	DN- 250 mm	m'	10	9.50	95.00
	c	për kolektorë DN- 400 mm	m'	150	21.00	3,150.00
	d	për kolektorë DN- 630 mm	m'	100	45.00	4,500.00
	e	për kolektorë DN- 800 mm	m'	40	70.00	2,800.00
					<b>TOTALI</b>	<b>11,000.00</b>

	<b>5.0 TESTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT ATMOSFERIK</b>					
--	--	--	--	--	--	--



5	5.1	Testimi i rrjetit të kanalizimit ATMOSFERIK sipas normave teknike, nga kompanija e certifikuar për këtë lloj aktiviteti, si dhe përpilimi i raportit me shkrim për këtë testim. Raporti i testimit duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	300	1.50	450.00	
						TOTALI	450.00

KANALIZIMIN ATMOSFERIK		
• "Rruga "Bedrush Çollaku"		
1.0	PUNËT E DHEUT	7,427.50
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME	2,085.00
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE	2,338.00
4.0	PUNËT MONTUESE	11,000.00
5.0	TESTIMI I RRJETIT	450.00
Totali:		23,300.50

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN FEKAL						
• "Rruga "Bedrush Çollaku"						
Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT				
	1.1	Trasimi-piketimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike sipas projektit, i cili shërben për përcjelljen e punimeve, gjatë ekzekutimit të punimeve të kanalizimit.	m'	405	1.00	405.00
	1.2	Inçizimi, i rrjetit sipas gjendjes së ekzekutuar të kanalizimit (pas ekzekutimit të rrjetit të kanalizimit). Inçizimi gjeodezik duhet të bëhet nga kompanija e licensuar për këtë lloj aktiviteti. Materiali duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.	m'	405	1.00	405.00
	1.3	Realizimi i lidhjeve të gypave të kanalizimit fekal nga objektet egzistuese në rrjetin e ri të kanalizimit, duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	11	30.00	330.00
	1.4	Realizimi i lidhjes së gypit të projektuar në pusetat ekzistues për shkarkim duke përfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme për një funksionim të plotë.	copë	1	100.00	100.00
	1.5	Gërmimi me dorë, makinë dhe Çekan dhe transporti deri në deponi i dheut, me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në H=3,0m', kurse gjërësia varet nga profili (Ø) i gypit, në çmim duhet llogaritur edhe mbrojtja e kanalit nga shembja				
	a	gërmimi me makinë 90%	m³	990	3.00	2,970.00
	b	gërmimi me dorë 10%	m³	110	3.50	385.00





1.6	Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësin e kanalit.(sipas normativave, kur thellësia e kanalit është H>2.0m).	m'	405	2.50	1,012.50
1.7	Zgjerimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol.	m <sup>3</sup>	30	10.00	300.00
1.8	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m <sup>2</sup>	446	1.00	445.50
1.9	Furnizimi, shtrirja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt:	m <sup>3</sup>	22	8.00	176.00
1.10	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	405	0.50	202.50
1.11	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m2.	m <sup>3</sup>	687	9.00	6,183.00
1.12	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	6	10.00	60.00
<b>TOTAL PUNËT E DHIEUT :</b>					<b>12,974.50</b>

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
<b>2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME</b>						
2	2.2	Përpunimi i fundit të pusëtës kontrolluese me C-20/25 (për punimin e pllakes nga betoni dhe kinetave) . Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 30cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.				
	a	<b>për puseta rrugore</b>	m <sup>3</sup>	7	100.00	700.00
	2.3	Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën pusetë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të cilin montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusëtës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				
	a1	Unaza në formë të konit (për puseta rrugore)	copë	14	25.00	350.00
	b1	Me profil konstant (për puseta rrugore)	m'	33	15.00	495.00
<b>TOTALI</b>					<b>1,545.00</b>	

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
<b>3,0 PUNËT METAL PUNUESE</b>						



3	3.1	Furnizimi transporti montimi i kapakëve prej gize DN-600 mm, konform Standardit EN124, klasa D400 kN. pesha e kapakut T=40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej beton-armesë C-25/30. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.				
	a	për puseta rrugore	copë	14	100.00	1,400.00
	3.2	Shkallët në puseta Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusetës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logaritja me copë.				
	a	për puseta rrugore	copë	70	25.00	1,750.00
					<b>TOTALI</b>	<b>3,150.00</b>


<b>4.0 PUNËT E MONTUESE</b>						
4	4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar të kanalizimit PE SN8, në bazë të standardit EN 13476-3 dhe ISO 9969, duke përfshirë edhe lidhjen e gypave me puselen e kanalizimit, duke mbyllur zbrazdësirat me llaq qimento, në mënyrë që të mos ketë infiltrime të ujrave anësore si dhe ujrave nëntokësore në puseta. Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet.				
	b	DN- 160 mm	m'	130	5.50	715.00
	c	DN- 315 mm	m'	230	13.50	3,105.00
	d	për kolektorë DN- 400 mm	m'	40	21.00	840.00
					<b>TOTALI</b>	<b>4,660.00</b>

<b>5.0 TESTIMI I RRJETIT TË KANALIZIMIT FEKAL</b>							
5	5.1	Testimi i rrjetit të kanalizimit fekal sipas normave teknike, nga kompanija e certifikuar për këtë lloj aktiviteti, si dhe përpilimi i raportit me shkrim për këtë testim. Raporti i testimit duhet të dorëzohet investitorit në 3 kopje të forta si dhe në kopje elektronike.		405	1.50	607.50	
				m'			<b>TOTALI</b>

<b>KANALIZIMI FEKAL</b>		
<b>• "Rruga "Bedrush Çollaku"</b>		
1.0	PUNËT E DHEUT	12,974.50
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME	1,545.00
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE	3,150.00
4.0	PUNËT MONTUESE	4,660.00
4.0	TESTIMI I RRJETIT	607.50
<b>Totali:</b>		<b>22,937.00</b>


Rruga Bedrush Çollaku, Instalimet Elektrike, Kanalizimi i Kabllëve dhe Ormanëve Distributiv të jashtëm Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuar janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet të prezantojë përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim. Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshijë certifikatat e kualitetit dhe të standardeve si dhe broshurat apo katalogjet e produkteve me të dhënat teknike të produktit me të cilat merr pjesë në tender. OE është i obliguar që t'i sjell edhe certifikatat e garancionit për pasijet në fjalë të cilat paisje duhet të jenë plotësisht të njëjta me të dhënat teknike të përshkruara në katalogje apo broshura, po ashtu duhet të sjellë edhe certifikatën e origjinës së materialeve.

Pos.1	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
<b>1. KANALIZIMI KABLLOVIK</b>					



1.1.1	Gërmimi i kanalit të gjatë 1110 m, në skajin e djathtë të rrugës prej rrugës prej profilit P2 deri te profili P28 dhe në skajin e majtë të rrugës prej profilit P29 deri te profili P72, me dimensione (120x90)cm, ashtu siç është paraqitur në situacion, për shtrirjen e gypave PE të brinjezuar Ø200mm, Ø160mm, Ø70mm. Në çmim të kalkulohet edhe largimi i dheut nga punishtja me largësi min 15km. Në këtë pozicion lypë edhe planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m <sup>3</sup>	320	3.50	1,120.00
1.1.2	Porosia, transporti dhe vendosja e gypave 4x RESN4 Ø200 të brinjezuar për përshkim të mevonshëm të rrjetit elektroenergetik. Shtresa e brendshme e gypit duhet të jetë e verdhe kurse pjesa e jashtme e zeze me 4 vija të kuqe për rriatesi	m	1325	4.00	5,300.00
1.1.3	Porosia, transporti dhe vendosja e gypave RESN4 Ø160 të brinjezuar për përshkim të mevonshëm të rrjetit të tensioneve uleta. Shtresa e brendshme e gypit duhet të jetë e verdhe kurse pjesa e jashtme e zeze me 4 vija të kuqe për rriatesi	m	320	3.50	1,120.00
1.1.4	Porosia, transporti dhe vendosja e gypave RESN4 Ø70 të brinjezuar për përshkim të kabllit për ndriçim .	m	320	2.00	640.00
1.1.5	Hapja dhe gropimi i 10 pusetave elektroenergetike me dimensione të jashtme (200x200x210 cm) dhe dimensionet e brendshme 160x160x180cm. Dheu i tepert të largohet nga punishtja në largësi min 15km.	m <sup>3</sup>	70	10.00	700.00
1.1.6	Furnizimi transporti si dhe vendosja me betonarme e 10 pusetave energjetike me dimensione të jashtme 2.0/2.0/2.1 m', trashësia e mureve 20cm dhe i lyp me material hidroizolues. Pusetat duhet të punohen nga betoni C-25/30 dhe armatura rrejt 2xQ503 . Në çmim të kalkulohet komplet puseta e perfunduar dhe kapaku katror 0.65/0.65 m' , nga materiali kompozit, për rrekesa T=40 ton.	copë	10	900.00	9,000.00
1.1.7	Furnizimi transporti dhe shenjzimi i pusetave me shenja të mesingut për tension	cope	10	30.00	300.00
1.1.8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gypave Ø70 për lidhjen e pusetave me pusetat e kanalizimit atmosferik me gjatësi mesatare 15m (për drenazhim të pusetave)	copë	10	15.00	150.00
1.1.9	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit (0-4)mm në fundin e kanalit (140m) 10cm, anash 10cm, mes gypave 5 cm dhe mbi gypa 20 cm, me ngjeshje në kanalën me dimensione 120x90cm. Ky material duhet të punohet me dorë dhe të ngjeshet.	m <sup>3</sup>	180	8.00	1,440.00
1.2.1	Mbulimi i kanalit (140 m) me dimensione 120x90cm (Mbulimi i tere me zhavor (0-60)mm). Ngjeshja në shtresë çdo 30cm deri në kuotën e terrenit.	m <sup>3</sup>	135	10.00	1,350.00
1.2.2	Furnizimi transporti dhe vendosja e mbrojtës të tipit GAL.	m	320	1.00	320.00
1.2.3	Furnizimi transporti vendosja e shiritit identifikues "Rezik tensioni"	m	320	0.50	160.00
1.2.4	Punët e paparapara në paramasë	copë	1	250.00	250.00
<b>TOTAL POZICIONI 1</b>					<b>21,850.00</b>

2. NDRIQIMI PUBLIK



2.1.1	Gërmimi i kanalit të gjatë 5 m prej trafos deri te kuadri shpërndarës I ndriçimit (KSHN), me dimensione (80x50)cm, ashtu siç është paraqitur në situacion, për shtrirjen e gypave PE të brinjëzuar Ø70m. Në çmim të kalkulohet edhe largimi i dheut nga punishtja me largësi min 15km. Në këtë pozicion hynë edhe planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m <sup>3</sup>	3	3.50	10.50
2.1.2	Porosia, transporti dhe vendosja e gypave RESN4 Ø 70 të brinjëzuar për pershkim të kablilit prej trafos deri te kuadri shpërndarës i ndriçimit publik KSHN.	m	6	2.50	15.00
2.1.3	Furnizimi dhe vendosja e kabllos kryesore furnizuese NAYY- 4x35mm <sup>2</sup> prej TS deri te kuadri kryesorë shpërndarës i ndriçimit KSHN (10 m).	m	12	7.00	84.00
2.1.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shiritit të zinguar Fe/Zn25x4mm në kanalizimin kablovik për tokezimin e shtyllave të ndriçimit.	m	10	2.50	25.00
2.1.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit (0-4)mm në fundin e kanalit (5 m) prej trafos deri te KSHN, me dimensione (80x50) 10 cm dhe 20 cm mbi gypin e brinjëzuar Ø70mm.	m <sup>3</sup>	1	15.00	15.00
2.1.6	Mbulimi i kanalit (10m) me dimensione (80x50cm). Mbulimi i tere me zhavor (0-60)mm). Ngjeshja në shtresë çdo 30cm deri në kuotën e terrenit.	m <sup>3</sup>	1	10.00	12.00
2.1.7	Furnizimi transporti dhe vendosja e mbrojtës të tipit GAL.	m	5	1.00	5.00
2.1.8	Furnizimi transporti vendosja e shiritit identifikues "Rezik tensioni"	m	5	0.50	2.50
2.1.9	Furnizimi dhe vendosja e kabllos furnizuese NAYY- 4x25mm <sup>2</sup> prej kuadrit shpërndarës të ndriçimit (KSHN) në Daljen 1 (540m)(me 22shtylla N1-N22) dhe Daljen 2 (540) (me 22 shtylla N23-N44) për furnizimin e trupave ndriçues, kablo vendoset në gypin e brinjëzuar Ø70.	m	350	5.00	1,750.00
